



OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË  
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 12

08 shkurt 2025

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Historikisht industria ka luajtur rol përcaktues në krijimin e modeleve të zhvillimit të hapësirave të ndryshme gjeografike të botës.

a) Përshkruani zhvillimin e industrisë moderne në Evropë. Si ndikoi ajo në ndryshimin e hapësirës gjeografike evropiane? **2 pikë**

Industria moderne e karakterizuar nga numri i madh i të punësuarve dhe përdorimi i makinerive dhe kapitaleve lindi dhe u zhvillua fillimisht në Angli në gjysmën e dytë të shekullit XVII e cilësuar si Revolucioni industrial. Nga ky moment duke u përhapur gradualisht në të gjithë kontinentin kjo industri ndikoi në transformimin e hapësirës gjeografike të Evropës. Lindën dhe u zhvilluan gradualisht rajonet e para industriale me përqendrim të lartë të fabrikave pranë vendburimeve të minerale të ndryshme kryesisht ato të qymyrgurit.

Në mesin e shekullit XVIII industrializimi u përhap edhe më shumë në pellgjet qymyrgur mbajtëse të Belgjikës, të Francës Veriore, Ruhrit në Gjermani dhe Silezinë e Sipërme në Poloni. Në fund po të këtij shekulli industrializimi përfshiu dhe Italinë veriperëndimore, Suedinë dhe Rusinë.

b) Që nga fillimet e industrisë moderne e në vazhdim, peizazhi industrial i botës ka ndryshuar e po rristruket. Shpjegoni tri nga aspektet me të cilat shprehet ky ndryshim dhe rristruketim i peizazhit industrial të botës. **6 pikë**

- *Me ndryshimin e strukturës së degëve të industrisë* ku nga njëra anë është vënë re rënie e rëndësisë së degëve tradicionale, ndërsa nga ana tjetër vëhet re rritje e rëndësisë në degë të reja dhe moderne si në ato të elektronikës, bioteknologjisë etj.
- *Me rristruketimin hapësinor të industrisë*, ku është zhvendosja e saj nga qytetet dhe qendrat metropole drejt periferisë së tyre.
- *Me rëndësinë që po marrin shumë aktivitete të reja industriale* në kuadër të sektorit të tretë të ekonomisë si: industria e marketingut, planifikimit, turizmit etj.

c) Shpjegoni rëndësinë e principit të "*kompleksitetit industrial*" në zhvillimin e modelit hapësinor industrial? **2 pikë**

Kompleksiteti industrial synon realizimin e produkteve të ndryshme industriale brenda të njëjtës hapësirë industriale. Ky princip ka rëndësi sepse industrinë ndërveprojnë dhe zhvillohen në një hapësirë gjeografike dhe ekonomike. Kjo do të thotë hapësirë gjeografike me infrastrukturë të përbashkët, forcë punëtore të specializuar, shërbime mbështetëse dhe tregje të afërta.

2. Shkruani në formën e një eseje argumentuese zhvillimin ekonomik të Amerikës së Veriut, duke u ndalur edhe në zhvillimet globale. 10 pikë

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

***Hyrja / prezantimi – 2 pikë***

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

***Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë***

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit. Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

***Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë***

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

3. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me çështjet e mëposhtme dhe një përfundim.

**Tema e esesë: "Ndryshimet klimatike dhe planeti ynë".**

**10 pikë**

**Çështjet:**

Analizoni faktorët që kanë ndikuar në ndryshimet klimatike.

Pasojat e ndryshimeve klimatike (sociale, mjedisore, ekonomike etj.)

Propozoni alternativa për reduktimin e pasojave të ndryshimeve klimatike.

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

***Hyrja / prezantimi – 2 pikë***

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

***Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë***

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit. Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

***Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë***

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

4. Shkruani një ese të mirë organizuar që përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me çështjet e mëposhtme dhe një përfundim.

**Tema e esesë:** Fenomeni i plakjes së popullsisë dhe adresimi i zgjidhjeve për këtë problem.

**10 pikë**

**Çështjet:**

Përkthejeni se si po ndryshon popullsia vitet e fundit.

Analizoni pasojat e plakjes së popullsisë.

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

**Hyrja / prezantimi – 2 pikë**

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

**Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë**

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

**Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë**

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

5. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me çështjet e mëposhtme dhe një përfundim.

**Tema e esesë:** Pabarazitë mjedisore dhe zgjerimi urban. Urbanizimi mes sfidave mjedisore, sociale dhe ekonomike.

**10 pikë**

**Çështjet:**

Analizoni sfidat mjedisore, sociale, dhe ekonomike të urbanizimit.

Vlerësoni pabarazitë mjedisore që lidhen me urbanizimin.

Vlerësoni avantazhet dhe disavantazhet e urbanizimit.

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

**Hyrja / prezantimi – 2 pikë**

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

**Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë**

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

**Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë**

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.